

LIGJI  
PËR AKADEMIN SLOVENE TW SHKENCAVE  
DHE ARTEVE

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Akademia Sllovene e Shkencave dhe Arteve (në tekstin më tej do të referohet: SASA) është institucioni më i lartë kombëtar i shkencave dhe arteve.

Neni 2

SASA është një institucion autonom që lidh bashkë shkencëtarë dhe artistë - anëtarë të SASA. SASA është një person juridik publik me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin e SASA-s.

Republika e Sllovenisë ofron kushte për funksionimin dhe zhvillimin e SASA-s.

Neni 3

SASA kultivon, inkurajon dhe promovon shkencat dhe artet dhe, nëpërmjet aktiviteteve të saj, kontribuon në zhvillimin e mendimit shkencor dhe krijimtarisë në art:

- duke adresuar çështje themelore të shkencave dhe arteve;
- duke marrë pjesë në krijimin e politikave të veprimtarive kërkimore dhe krijimtarisë në art;
- duke dhënë vlerësime, propozime dhe mendime mbi pozicionin, zhvillimin dhe promovimin e shkencave dhe arteve, si dhe duke organizuar aktivitete në funksion të kërkimit shkencor dhe krijimtarisë në art;
- duke marrë pjesë në diskutime mbi çështjet e përbashkëta sociale dhe ekonomike;
- duke mbështetur aktivitete shkencore, kulturore dhe artistike të të gjitha pjesëve të kombit slloven;
- duke inkurajuar aktivitete shkencore dhe artistike të anëtarëve të bashkësive etnike italiane dhe hungareze në Slloveni;
- duke krijuar mundësi për punën shkencore dhe artistike të anëtarëve të saj;

- duke organizuar punën kërkimore, edhe në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet e tjera kërkimore, veçanërisht në fushat që janë të rëndësishme për vetëdijesimin, njohjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të kombit slloven dhe për zhvillimin e gjuhës dhe kulturës së tij;
- duke krijuar institute në fushat e veprimtarive shkencore, kërkimore dhe kulturore;
- duke organizuar debate, takime të ekspertëve, konsultime, leksione dhe ekspozita;
- duke bërë botime të rregullta dhe të specifike në fushat e shkencave dhe arteve;
- duke zhvilluar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e shkencave dhe arteve.

#### Neni 4

SASA bashkëpunon me akademitë e tjera të shkencave dhe arteve dhe me organizata të tjera shkencore dhe artistike jashtë vendit dhe koordinon për projekte të përbashkëta dhe për zbatimin e tyre.

#### Neni 5

Në përmbushjen e përgjegjësive, SASA bashkëpunon me institute kërkimore, universitare dhe artistike, organizata biznesi, agjenci qeveritare dhe me shkencëtarë dhe artistë individualë.

Në zbatimin e projekteve që kërkojnë bashkëpunimin e një rrethi më të gjerë shkencëtarësh, artistësh dhe institutësh, SASA krijon komitete të përhershme ose organe ad hoc të punës, duke përfshirë shkencëtarë dhe artistë përveç anëtarëve të SASA-s.

#### Neni 6

SASA bashkëpunon me autoritetet dhe organizatat kompetente në formulimin e politikave dhe programeve të veprimtarive në fushat e kërkimit shkencor, kulturës dhe arsimit në Republikën e Sllovenisë.

#### Neni 7

Puna e SASA-s është publike. SASA informon publikun për punën e vet gjatë vitit të kaluar. Karakteri publik i punës së SASA-s rregullohet në mënyrë të detajuar nga Statuti i SASA-s.

#### Neni 8

SASA ka statutin e vet. Statuti i SASA-së përcakton organizimin, mënyrën e punës dhe menaxhimin e SASA-s në përputhje me këtë ligj.

Statuti miratohet nga Asambleja e SASA-s. Qeveria e Republikës së Sllovenisë do të japë pëlqimin e saj për dispozitat e Statutit që lidhen me financimin e SASA-s.

SASA mund të miratojë aktet të tjera nënligjore, të cilat në pajtim me Statutin, rregullojnë disa çështje me rëndësi për punën dhe aktivitetet e SASA-s.

#### Neni 9

Rregullat e përgjithshme për kërkimin shkencor dhe veprimtarinë artistike do të zbatohen për punën e SASA-s në fushën e kërkimit dhe veprimtarive artistike, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.

## II. ANËTARËT E SASA-s

### Neni 10

SASA siguron kuadrin për aktivitetet e shkencëtarëve dhe artistëve të cilët janë zgjedhur si anëtarë të saj për arritjet e tyre të jashtëzakonshme në fushën e shkencave dhe arteve. Zgjedhja si një anëtar i SASA-s është një shenjë e njohjes kombëtare dhe shoqërore. SASA ka anëtarë nderi, anëtarë të rregullt, anëtarë të asociuar dhe anëtarë korrespondentë. Anëtarët e rregullt kanë të drejtën e titullit 'Akademik'.

### Neni 11

Anëtarësia e nderit në SASA përfshin çdo person që ka pasur kulturën sllovene jashtëzakonisht të pasuruar përmes punës së tij shkencore ose artistike, ose që ka dhënë shërbim veçanërisht të merituar ndaj kombit slloven dhe për zhvillimin e shkencave apo arteve të tij.

Anëtarësimi i rregullt në SASA mund të shtrihet tek një shkencëtar ose artist i cili është shtetas i Republikës së Sllovenisë dhe ka kryer vepra veçanërisht të rëndësishme, që përfaqësojnë arritje kulmore në fushat e shkencave apo arteve.

Anëtarësimi i asociuar në SASA mund të shtrihet tek një shkencëtar ose artist i cili është shtetas i Republikës së Sllovenisë dhe ka krijuar vepra të një rëndësie të tillë që përmes tyre ka pasuruar në thelb shkencat apo artet.

Anëtarësimi i plotë dhe / ose i asociuar i SASA mund të shtrihet tek një shkencëtar ose artist me origjinë sllovene, i cili nuk është shtetas i Republikës së Sllovenisë, nëse është i lidhur në mënyrë aktive me atdheun e tij dhe ka krijuar vepra veçanërisht të rëndësishme në fushat e shkencave ose arteve.

Anëtarësimi korrespondent në SASA mund të shtrihet tek një shkencëtar ose artist i cili nuk është shtetas i Republikës së Sllovenisë, nëse plotëson kushtet e tjera për anëtarësim të plotë dhe ka kontribuar shërbime të rëndësishme për shkencat apo artet në Republikën e Sllovenisë.

### Neni 12

Anëtarët e SASA-s zgjidhen nga Asambleja e SASA-s. Procedura e zgjedhjeve për anëtarët e SASA-s përcaktohet nga Statutet. SASA ka 60 anëtarë të rregullt dhe 30 anëtarë të asociuar, dhe një maksimum prej 90 anëtarësh korrespondentë. Ky kufizim ka të bëjë me anëtarët nën 75 vjeç. Ndërprerja e anëtarësisë përcaktohet në detaje nga Statuti i SASA-s.

### Neni 13

Zgjedhja e anëtarëve të SASA-s zhvillohet çdo dy vjet. Anëtarët e rregullt dhe korrespondentë zgjidhen vetëm nga anëtarët e rregullt; anëtarët e nderit dhe të asociuar, megjithatë, zgjidhen nga anëtarët e rregullt dhe të asociuar.

Zgjedhjet zhvillohen me votim të fshehtë. Votimi me votë të fshehtë, në raste të jashtëzakonshme, mund të përfshijë edhe votat e anëtarëve që nuk arrijnë të jenë të pranishëm, për ata anëtarë që nuk mund të marrin pjesë në zgjedhje për shkak të problemeve me shëndetin ose arsyeve të tjera të justifikueshme.

Statuti i SASA-së specifikon në detaje kriteret për zgjedhjen dhe procedurën për nominimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të SASA-s.

### Neni 14

Pas zgjedhjes, anëtarët e SASA-s marrin përsipër përgjegjësinë e angazhimit për të zbatuar objektivat dhe detyrat e SASA-s. Përveç të drejtave dhe detyrave, të përcaktuara me ligj, anëtarët e SASA-s kanë këto të drejta dhe detyra të posaçme:

- të veprojnë në mënyrë krijuese në fushat përkatëse të shkencave dhe arteve;
- të marrin pjesë në punën shkencore dhe artistike në kuadër të programit SASA-s;
- të votojnë dhe të zgjidhen në organet drejtuese dhe punuese të SASA-s;
- të marrin pjesë në punët organizative dhe në organet (grupet) e punës në të cilat ata janë bërë anëtarë;
- të marrin pjesë në Asambletë e SASA-s dhe në seancat e Seksioneve.

### Neni 15

Anëtarët e rregullt dhe të asociuar të SASA, shtetas të Republikës së Sllovenisë me vendbanim të përhershëm në Slloveni, kanë të drejtë për shpërblim të përhershëm mujor. Statuti i SASA parashikon kriteret dhe shumën e shpërblimit.

### III. ORGANIZIMI I SASA-s

#### Neni 16

Aktivitetet shkencore dhe artistike të SASA-s kryhen në kuadër të Seksioneve dhe nënseksioneve të tyre, si dhe në Qendrën e Kërkimit Shkencor të SASA (në tekstin e mëtejshëm: QKSH e SASA). Seksioneve të SASA-s u besohet kryerja e detyrave të SASA-s; ato janë ngritur për një ose më shumë fusha të shkencave dhe arteve. Seksionet e SASA-s, dhe fushat për të cilat ato janë themeluar, përcaktohen nga Statutet e SASA-s. Anëtarët e rregullt dhe të asociuar të SASA-s, ekspertë të një disipline të veçantë shkencore ose artistike, punojnë së bashku në një Seksion të SASA-s. Çdo anëtar i rregullt dhe i asociuar i SASA-s mund të marrë pjesë aktive brenda kuadrit të një Seksioni. Puna e çdo Seksioni të SASA-s kryhet nga Sekretari. Anëtarët përkatës klasifikohen në Seksione të përshtatshme në varësi të disiplinës së tyre shkencore dhe artistike. Brenda kuadrit të Seksioneve, mund të krijohen nënseksione individuale për kryerjen e detyrave në fushat e përzgjedhura të shkencave dhe arteve. Statuti i SASA-s rregullon në detaje organizimin dhe funksionimin e SASA Seksioneve, si dhe bashkëpunimin e anëtarëve përkatës.

#### Neni 17

SASA dhe institutet që janë themeluar nga SASA mund të përfshijnë bibliotekat, galeritë dhe njësi të ngjashme.

## IV MENAXHIMI I SASA-s

### Neni 18

Organet drejtuese të SASA-s janë Asambleja, Kryesia dhe Kryetari.

### Neni 19

Asambleja e SASA-s është organi drejtues i SASA-s, e përbërë nga të gjithë anëtarët e rregullt dhe të asociuar të SASA-s. Anëtarët e nderit dhe korrespondentë të SASA-s mund të marrin pjesë gjithashtu në punën e Asamblesë.

Asambleja e SASA-s mblidhet të paktën një herë në vit.

Asambleja mblidhet nga Kryesia e SASA-s me nismën e vet, me propozimin e së paku dy Seksioneve të SASA-s, ose me propozimin e së paku dhjetë anëtarëve të rregullt të SASA-s.

Statuti i SASA-s përmban dispozita që përcaktojnë pjesëmarrjen e anëtarëve të nderit dhe korrespondentë të SASA-s në punën e Asamblesë së SASA-s.

### Neni 20

Asambleja e SASA-s:

- diskuton çështjet themelore në lidhje me realizimin e detyrave të SASA-s;
- miraton programin e punës së SASA-s;
- zgjedh anëtarët e SASA;
- zgjedh dhe rizgjedh Kryetarin, dy nënkryetarët dhe Sekretarin e Përgjithshëm të SASA-s;
- miraton statutet e SASA-s;
- miraton aktet për themelimin e instituteve;
- miraton buxhetin dhe llogaritë vjetore të SASA-s;
- miraton statutet e instituteve të themeluara;
- kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin e SASA-s.

### Neni 21

Asambleja miraton vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm shumica e anëtarëve të rregullt dhe të asociuar. Kërkohet shumica e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe të asociuar për miratimin e Statutit, për zgjedhjen e Kryetarit, dy nënkryetarëve dhe Sekretarin e Përgjithshëm, dhe për zgjedhjen e anëtarëve të nderit dhe të asociuar.

Megjithatë, për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt dhe korrespondentë kërkohet shumica e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt.

#### Neni 22

Kryesia e SASA përbëhet nga Kryetari, dy Zëvendëskryetarët, Sekretari i Përgjithshëm, Sekretarët e Seksioneve dhe tre anëtarë të SASA-s të zgjedhur nga Asambleja e SASA-s në pajtim me Statutin e SASA-s.

Kryesia e SASA-s është përgjegjës për zbatimin e vendimeve dhe direktivave të Asamblesë. Çështjet aktuale të Kryesisë trajtohen nga Bordi Ekzekutiv, i përbërë nga Kryetari, dy Zëvendës Kryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 23

Kryetari i SASA-s do të përfaqësojë dhe do të veprojë për SASA, dhe do të jetë përgjegjës për ligjshmërinë e punës së SASA-s.

Kryetari i SASA-s është përgjegjës për punën e tij dhe i raporton Asamblesë së SASA-s dhe në kuadër të detyrave të kryera nga Kryesia - tek Kryesia e SASA-s.

#### Neni 24

Kryetari, dy ZëvendësKryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm zgjidhen nga Asambleja e SASA-s nga anëtarët e rregullt. Sekretarët e seksioneve zgjidhen nga anëtarët e Seksionit nga anëtarët e rregullt dhe të asociuar. Kryetari, dy nënkryetarët, Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretarët e seksioneve zgjidhen për një periudhë prej tre vjetësh me mundësinë e një rizgjedhjeje të mëtejshme.

Kryetari, dy nënkryetarët, Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretarët e seksioneve mund ta kryejnë këtë funksion deri në moshën 75 vjeçare.

Statutet e SASA-së specifikojnë në detaje kriteret për zgjedhje dhe procedurën për emërimin dhe zgjedhjen e Kryetarit, dy nënkryetarëve, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Sekretarëve të Seksioneve të SASA-s.



## V ADMINISTRIMI I SASA-s

### Neni 25

Shërbimet administrative-teknike, ndihmëse dhe të ngjashme, me interes të përbashkët për SASA-n kryhen nga Administrata e SASA-s.

Administrata e SASA drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv i cili do të emërohet dhe do të ri-emërohet nga Kryesia.

Drejtori Ekzekutiv emërohet për një periudhë katër vjeçare dhe mund të riemërohet. Ai është përgjegjës për punën e tij dhe i raporton Sekretarit të Përgjithshëm të SASA-s.

Kryesia e SASA-s do të ketë një Sekretar i cili emërohet për një periudhë katër vjeçare dhe mund të riemërohet.

## VI. QENDRAT E KËRKIMIT SHKENCOR TË SASA-s

### Neni 26

SASA është themeluese e Qendrës Kërkimore Shkencore të Akademisë Sllovene të Shkencave dhe Arteve (QKSH e SASA-s).

Së bashku me SASA-n, QKSH po zbaton programin e përbashkët afatgjatë të njohur si Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Kombit Slloven.

QKSH e SASA-s kryen detyrat themelore në fushën e shkencave natyrore, shkencave humane dhe sociale. QKSH e SASA-s vepron sipas Ligjit për Institutet dhe kryen kërkime shkencore në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë kërkimore.

Aktivitetet kërkimore në QKSH të SASA-s kryhen nga anëtarët e SASA-s, nga kërkuesit që mbajnë tituj shkencorë të akorduar nga SASA dhe nga kërkues me tituj të tjerë.

Titulli i bashkëpunëtorit shkencor, i akorduar nga SASA, përcaktohet me këtë ligj.

## VII. BASHKËPUNËTORË SHKENCORE TË SASA

### Neni 27

Titujt e bashkëpunëtorëve shkencorë, të akorduar nga SASA, janë: këshilltari shkencor i SASA-s, bashkëpunëtor i lartë shkencor i SASA-s dhe bashkëpunëtor shkencor i SASA-s.

## VIII. FONDET E SASA-s

### Neni 28

Fondet për funksionimin e SASA-s do të sigurohen nga Republika e Sllovenisë nga buxheti i saj, dhe janë të destinuara për:

- punën e Asamblesë, Kryesisë dhe Seksioneve të SASA-s;
- programin bazë të punës të SASA-s;
- Programin e punës së anëtarëve të pensionuar të rregullt dhe të asociuar të SASA-s;
- veprimtari të rregullta botuese;
- shpërblime të përhershme mujore për anëtarët e rregullt dhe të asociuar të SASA-s;
- amortizimin, investimet dhe mirëmbajtjen e investimeve;
- kryerjen e punës profesionale, administrative dhe teknike;
- shpenzimet materiale dhe operative;
- kompletimin e bibliotekës, blerjen e trashëgimisë dhe të veprave të artit me rëndësi për trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

SASA siguron fonde sipas paragrafit më sipër nga buxheti i Republikës së Sllovenisë në bazë të programit vjetor të punës të vlerësuar financiarisht, që i është dorëzuar Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për miratim.

Përveç kësaj, SASA siguron fonde për kërkim dhe punë artistike përmes hulumtimeve kontraktuale dhe aktiviteteve artistike.

SASA mund të sigurojë fonde edhe përmes granteve, trashëgimisë dhe donacioneve, ose me mjete të tjera ligjore.

### Neni 29

Fondet për funksionimin e QKSH të SASA-s do të sigurohen nga buxheti i Republikës së Sllovenisë në mënyrë dhe shuma të ngjashme me ato të parashikuara për institutet kërkimore publike.

QKSH e SASA siguron fondet nga paragrafi më sipër nga buxheti i Republikës së Sllovenisë në bazë të programit vjetor të punës të vlerësuar financiarisht.

Organi më i lartë i menaxhimit të QKSH të SASA-s kërkohet të marrë pëlqimin për programin e tij të punës nga Kryesia e SASA-s dhe nga Ministria kompetente për aktivitetet kërkimore.

QKSH e SASA-s gjithashtu ka të drejtë të sigurojë fonde nga burime të tjera.

#### Neni 30

Gjykata e Auditit kryen mbikëqyrje financiare mbi veprimtarinë e SASA-s.

#### Neni 31

SASA është pronare e aseteve që i janë caktuar ose që ka fituar për kryerjen e veprimtarive për të cilat është themeluar.

## IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 32

SASA dhe QKSH e SASA-s do të sigurojnë që organizimi dhe operacionet e tyre, si dhe statutet dhe aktet e tjera nënligjore, të jenë në përputhje me këtë ligj jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të tij.

### Neni 33

Kryesia e SASA-s do të kufizojë numrin e vendeve vakante për secilin lloj të anëtarësimit në SASA në periudhat e ardhshme zgjedhore, derisa numri i anëtarëve të SASA të arrijë shifrën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 12 të këtij ligji.

### Neni 34

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, anëtarët korrespondentë të SASA-s do të quhen si anëtarë të asociuar të SASA dhe anëtarët korrespondentë të jashtëm do të quhen si anëtarë korrespondentë të SASA; dhe kështu do të fitojnë çdo të drejtë dhe detyrë sipas këtij ligji.

### Neni 35

Bashkëpunëtorët shkencorë të SASA-s që e kanë fituar këtë titull sipas Ligjit të mëparshëm për SASA-n (Gazeta Zyrtare e RS Sllovenisë, 30/80) e mbajnë atë titull deri në skadimin e periudhës për të cilën janë zgjedhur.

### Neni 36

Kryetari, dy nënkryetarët, Sekretari i Përgjithshëm, sekretarët e seksioneve dhe shefat e departamenteve të SASA do të kryejnë detyrat e tyre deri në mbarimin e mandatit për të cilin ata janë zgjedhur.

### Neni 37

QKSH e SASA-s, e themeluar nga SASA, me këtë ligj fiton të drejtat dhe detyrat e një instituti kërkimor publik.

### Neni 38

Më datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon së zbatuari Ligji për SASA (Gazeta Zyrtare e RS Sllovenisë, 30/80).

Neni 39

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e pesëmbëdhjetë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Sllovenisë.

Numri: 610-01 / 93-10 / 3 Lubjanë, 20 korrik 1994

**Kryetar  
i Asamblesë Kombëtare  
të Republikës së Sllovenisë  
Herman Rigelnik, MSc; m.p.**